

MONITORI I TË DREJTAVE PRONËSORE

Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE) punon me institucionet e Kosovës për të mbështetur zbatimin e kornizës së politikave dhe asaj ligjore për mbrojtjen e të drejtave pronësore e banesore të pjesëtarëve të komuniteteve në pozitë të cenueshme. Për të ndihmuar në këto përpjekje, OSBE monitoron dhe raporton rregullisht mbi zhvillimet, dhe i këshillon institucionet lidhur me respektimin e legjislacionit përkatës, standardeve ndërkombëtare dhe praktikave të mira. Monitori i të drejtave pronësore është botim gjashtëmujor që përmban vëzhgime të monitoruesve në terren të OSBE-së në pesë rajonet vijuese: Gjilan (GN); Mitrovicë (MI); Pejë (PE); Prishtinë (PR) dhe Prizren (PZ). Ky botim pasqyron në mënyrë të përmbledhur situatën në fushën e të drejtave pronësore dhe banesore të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë, personave të zhvendosur (PZH) dhe të komunitetit shumicë në zonat ku ata janë në pakicë numerike. Qëllimi i këtij botimi është t'u ndihmojë institucioneve përgjegjëse në adresimin e çështjeve shqetësuese përkitazi me zbatimin e legjislacionit dhe vendimeve, dhe shërben si mekanizëm për të përcjellë përparimin e shënuar dhe për t'i tejkaluar mangësitë e identifikuara. Informacioni i paraqitur më poshtë është mbledhur nga ekipet në terren të OSBE-së dhe i mbulon rrjedhimisht vetëm rastet në të cilat ekipet në terren kanë pasur qasje gjatë periudhës janar-qershor 2022.

BOTIMI 6: JANAR 2022 - QERSHOR 2022

TEMAT

Shpronësimi paraqet një ndërhyrje nga autoritetet në pronën private dhe publike, duke hequr të drejtat e pronësisë, me qëllim të arritjes së një interesi të caktuar publik. Ai realizohet sipas kushteve të parapara me ligj, ku parashihet edhe kompensimi për pronarët e prekur. Ky botim i Monitorit paraqet numrin e shpronësimeve që prekin pronat e grupeve në pozitë të cenueshme, me fokus të veçantë të pjesëtarët e komuniteteve joshumicë dhe PZH-të.

Uzurpimi i kundërligjshëm i pronës së paluajtshme është vepër penale sipas nenit 320 të Kodit Penal. Pronat e grupeve në pozitë të cenueshme, veçanërisht ato të komuniteteve joshumicë dhe PZH-ve, kanë qenë vazhdimisht objekt i uzurpimeve të kundërligjshme. Ky botim i Monitorit pasqyron numrin e uzurpimeve të kundërligjshme të pronës që kanë ndodhur gjatë periudhës për të cilën raportohet.

Banimi social është obligim i autoriteteve për të adresuar nevojat për banim të personave dhe familjeve që nuk mund të përballojnë vetë kushte të duhura të jetesës. Ky botim i Monitorit paraqet numrin e rasteve të grupeve të cenueshme, siç janë gratë dhe komunitetet joshumicë, që kanë përfituar banesa sociale.

Legalizimi është proces që drejtohet nga autoritetet me qëllim legalizimin e ndërtimeve pa leje. Ky botim pasqyron numrin e kërkesave dhe certifikatave të legalizimit të lëshuara për ndërtimet pa leje.

Planifikimi hapësinor është politikë e autoriteteve për rregullimin e hapësirave publike në të gjitha nivelet. Pjesëmarrja në procesin e hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor ka rëndësi thelbësore jo vetëm për vlerësimin dhe paraqitjen e nevojave të komuniteteve, por edhe për të siguruar mbrojtjen e të drejtave individuale pronësore. Ky botim pasqyron numrin e proceseve të planifikimit hapësinor ku është evidentuar pjesëmarrja e grupeve në pozitë të cenueshme, gjegjësisht e komuniteteve joshumicë, grave dhe rinisë.

Ndarja e tokës komunale për projekte që lidhen me kthimin është procedurë/iniciativë e autoriteteve që bëhet me qëllim të përmbushjes së interesit publik dhe/ose një politike publike. Ky botim paraqet numrin e komunave që kanë ndarë tokë komunale për projekte të kthimit dhe/ose për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë gjatë periudhës kohore për të cilën raportohet.

Tatimi mbi pronën e paluajtshme është pagesë e detyrueshme e paraparë dhe e zbatuar nga autoritetet për pronësinë/të drejtën e shfrytëzimit të pronave banesore, bujqësore dhe komerciale. Megjithatë, ka raste kur pronat e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë kanë qenë/janë të uzurpuara dhe si rrjedhojë e kësaj pronarët vazhdojnë të bartin barrën e detyrimit tatimor përkundër faktit se nuk gëzojnë posedim fizik të atyre pronave. Ky botim paraqet numrin e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë të liruar nga pagesa e tatimit për pronë të paluajtshme për pronat e uzurpuara në mënyrë të kundërligjshme.

RASTET LIDHUR ME TË DREJTAT PRONËSORE QË PREKIN KOMUNITETET JOSHUMICË NË MBARË VENDIN


SHPRONËSIMI	0
UZURPIMI I KUNDËRLIGJSHËM	1
BANIMI SOCIAL	0
LEGALIZIMI I NDËRTIMEVE PA LEJE	5996
PLANIFIKIMI HAPËSINOR	6
NDARJA E TOKËS PËR PROJEKTE QË LIDHEN ME PZH-të	0
TATIMI NË PRONËN E PALUAJTSHM	0

ZHVILLIMET

Shpronësimi

Gjatë periudhës për të cilën raportohet nuk është evidentuar asnjë rast i shpronësimit të pronave (parcelave) që u përkasin grupeve në pozitë të cenueshme, veçanërisht komuniteteve joshumicë apo PZH-ve.

RASTET E LEGALIZIMIT SIPAS RAJONIT




Uzurpimi i kundërligjshëm

Uzurpimi i kundërligjshëm i pronave të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë dhe PZH-ve vazhdon të ndikojë në të drejtat pronësore të këtyre grupeve të cenueshme. Në periudhën për të cilën raportohet është raportuar **një rast** i uzurpimit të kundërligjshëm të pronës në rajonin e Mitrovicës (pronë që i përket një serbi të Kosovës).

Banimi social

Gjatë periudhës për të cilën raportohet nuk është ndarë asnjë banesë sociale për grupet në pozitë të cenueshme.

RASTET E LEGALIZIMIT SIPAS RAJONIT




Legalizimi

Sipas legjislacionit ekzistues, objekti i ndërtuar në ngastrën e tokës së një pale tjetër nuk mund të legalizohet derisa të konstatohet pronësia ose e drejta e shfrytëzimit të asaj ngastre. Legjislacioni synon të mbrojë grupet e cenushme siç janë komunitetet joshumicë dhe/ose PZH-të në rast të uzurpimit të kundërligjshëm të tokës së tyre.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet janë parashtruar gjithsej 5,996 kërkesa për legalizim të ndërtimeve pa leje në mbarë Kosovën, përfshirë këtu 31 kërkesa nga komunitetet joshumicë (23 nga serbë të Kosovës, dy nga boshnjakë të Kosovës dhe gjashtë nga romë të Kosovës). Autoritetet komunale kanë lëshuar 2740 certifikata legalizimi, nga të cilat nëntë për prona që u përkasin pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë. Sidoqoftë, nuk është regjistruar asnjë rast i ndërtimeve të paligjshme mbi parcelat e tokave të uzurpuara të komuniteteve joshumicë dhe/ose PZH-ve.

Vlen të përmendet: Shumica e komunave në Kosovës nuk mbajnë të dhëna të kategorizuara sipas komunitetit për parashtruesit e kërkesave për legalizim.

PJESËMARRJA E KOMUNITETEVE JOSHUMICË NË PROCESE TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR SIPAS RAJONIT



Planifikimi hapësinor

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, gratë dhe/ose të rinjtë kanë marrë pjesë në gjashtë procese të planifikimit hapësinor – në rajonin e Pejës, Gjilanit dhe Prizrenit.

Ndarja e tokës

Gjatë periudhës për të cilën raportohet nuk është evidentuar asnjë rast i ndarjes së tokës komunale për projekte që lidhen me kthimin e PZH-ve apo për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë.

Tatimi në pronën e paluajtshme

Ligji nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme ka hyrë në fuqi më 1 tetor 2018. Sipas nenit 39 të këtij ligji, personat, prona e të cilëve rezulton të ketë qenë apo të jetë e uzurpuar në mënyrë të kundërligjshme sipas një vendimi përfundimtar të nxjerrë nga një autoritet publik, kompetent për të shqyrtuar rastet e uzurpimeve të paligjshme në Kosovë, lirohen nga detyrimet tatimore.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, asnjë pjesëtar i komuniteteve joshumicë dhe/ose PZH nuk është liruar nga pagesa e tatimit në pronën e paluajtshme.